

VENDIM
Nr. 434, datë 19.7.2023

**PËR MIRATIMIN E KOEFICIENTIT TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË
VLERËSUAR TË VITIT 2021 PËR LLOGARITJEN E PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2021, me indeksin 8.9% të llogaritur sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Indeksi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, aplikohet për rivlerësimin e bazës së vlerësuar të arritur nëpërmjet kontributeve të derdhura dhe rivlerësimeve të tyre, të kryera deri në vitin 2021, dhe zbatohet për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensioneve që do të caktohet me datë fillimi nga data 1 korrik 2023 e në vazhdim.

3. Indekset akumulative të bazës së vlerësuar, të arritur nëpërmjet pagave të periudhës 1994–2021, referuar kontributeve të derdhura sipas muajve në këtë periudhë dhe pagave referuese sipas punëve dhe profesioneve, e përcaktuar me vendimin nr. 561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, të ndryshuar, sipas viteve, janë sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Pas aplikimit të indeksit të vitit 2021, baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensioneve, që do të caktohen me datë fillimi nga data 1 korrik 2023, nuk mund të jetë më e lartë se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej 40 000 lekësh, e përcaktuar sipas vendimit nr. 113, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, për pagat e periudhës nga viti 1994 deri në 31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi, prej 176 416 lekësh, e përcaktuar sipas kriterëve të paragrafit të fundit, të nenit 10, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim dhe përballohen brenda buxhetit vjetor të miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2023.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA I

Tabela e koeficienteve akumulative të indeksimit të bazës së vlerësuar	
Për pagat referuese deri më datë 31.12.1993	10.799
Për pagat e vitit 1994	10.799
Për pagat e vitit 1995	8.691
Për pagat e vitit 1996	6.743
Për pagat e vitit 1997	6.743
Për pagat e vitit 1998	5.634
Për pagat e vitit 1999	4.573
Për pagat e vitit 2000	4.165
Për pagat e vitit 2001	3.563
Për pagat e vitit 2002	3.291
Për pagat e vitit 2003	2.945
Për pagat e vitit 2004	2.676
Për pagat e vitit 2005	2.430
Për pagat e vitit 2006	2.206
Për pagat e vitit 2007	2.108
Për pagat e vitit 2008	1.862
Për pagat e vitit 2009	1.713
Për pagat e vitit 2010	1.640
Për pagat e vitit 2011	1.578
Për pagat e vitit 2012	1.518
Për pagat e vitit 2013	1.455
Për pagat e vitit 2014	1.455
Për pagat e vitit 2015	1.257
Për pagat e vitit 2016	1.257
Për pagat e vitit 2017	1.233
Për pagat e vitit 2018	1.189
Për pagat e vitit 2019	1.161
Për pagat e vitit 2020	1.129
Për pagat e vitit 2021	1.089
Për pagat e vitit 2022	1.000
Për pagat e vitit 2023	1.000